

VENDIM
Nr.75, datë 12.12.2007

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC I KALIVACIT,
SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” nenit 10, pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.67, datë 10.12.2007 “Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie, i cili do të ndërtohet nga shoqëria “Kalivac Green Energy” sh.p.k.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta